



UNIVERSITETI I SHKODRËS

“Luigj Gurakuqi”

Nr. 1 Prot

Shkoder, më 06. 04 2016

VENDIM

Lënda: Konstituimi i Komisionit të Apelimit për zgjedhjet e para për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

Proçesverbal i mbajtur sot me datën, 06. 04. 2016, ora 10.00; në zbatim të ligjit nr. 8485 datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 80/2015 “ Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Rregullores nr. 2459/ 1, neni nr. 39 datë 15.03.2016 “ Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe vendimit të Senatit të U.SH nr. 149, datë 21.03.2016 u mblodh sot Komisioni i Apelimit për zgjedhjet e para për autoritetet dhe organet drejtuese, me praninë e anëtarëve z. Dritan Sallaku, Znj. Daorta Berdaj, zj. Ylvije Kraja, Z. Roland Ilia dhe zj. Aurora Dibra.

1. Komisioni mori vendimin për konstituimin e Komisionit të Apelimit për zgjedhjet e para për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.
2. Komisioni zgjodhi me shumicë të thjeshtë Kryetar të Komisionit të Apelimit për zgjedhjet e para për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” z. Roland Ilia.
3. Komisioni zgjodhi sekretarin e Komisionit të Apelimit për zgjedhjet e para për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” zj. Aurora Dibra.
4. Komisioni hartoi dhe miratoi rregulloren për funksionimin e tij.
5. Shpalli vendimin për konstituimin e Komisionit të Apelimit për zgjedhjet e para për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar

Roland Ilia

Aurora Dibra Sekretar

Dritan Sallaku Anëtar

Daorta Berdaj Anëtar

Ylvije Kraja Anëtar